



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 773/ Prot.

Tiranë, më 27.03.2018

URDHËR

Nr. 147; datë 27.03.2018

PËR


MIRATIMIN E STATUTIT TË KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË “KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Kolegjut Profesional të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”, propozuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 61/1 prot., datë 18.01.2018, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (21 faqe).
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Kolegjut Profesional të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës” të miratohen në zbatim të statutit të Kolegjut Profesional të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës” dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Kolegjut Profesional i Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”, brenda afatit ligjor, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të gjitha aktet dhe dokumentacionin ligjor për organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, sipas përcaktimeve të këtij statuti.
4. Ndryshimet në statutin e Kolegjut Profesional të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës” miratohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.
5. Statuti ekzistues i Kolegjut Profesional të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”, i miratuar me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (i shfuqizuar), shfuqizohet.
6. Statuti i Kolegjut Profesional të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”, hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Kolegji Profesional i Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



STATUTI I KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË "KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS"

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Kolegji Profesional i Tiranës, kolegj profesional i lartë, (këtu e në vazhdim KPT), e ushtron aktivitetin bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkençor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ("Ligji për Arsimin e Lartë"), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 26.04.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjut profesional të lartë, Urdhërin nr. 426, datë 06.11.2015 "Për lejimin për ushtrimin e veprimitarës akademike", si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse në fuqi.
2. KPT është krijuar me Vendimin Nr. 699, datë 26.08.2015 të Këshillit të Ministrave "Për licensimin e institucionit të arsimit të lartë, privat, me statusin e kolegjut profesional të lartë, "Kolegji Profesional i Tiranës".
3. Ky statut përcakton: organizimin, strukturat përbërëse të institucionit, veprimitarët e autoritetëve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen dhe emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve, si dhe çështje të tjera të cilat rregullojnë veprimitarët e kolegjut profesional të lartë "Kolegji Profesional i Tiranës", si institucion jopublik i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimi të larta me karakter profesional, pas arsimit të mesëm.

Neni 2 - Subjekti juridik

1. Kolegji Profesional i Tiranës është në pronësi të shoqërisë tregtare "KPT" SHPK, me NIPT L51420003Q, e cila është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrit më datë 20.02.2015.
2. Shoqëria tregtare "KPT" SHPK, garanton që politikat dhe organizimi i studimeve të janë në respektim të legjisacionit në fuqi, qëndrueshmërinë financiare të Kolegjut Profesional të Tiranës, me qëllim zhvillimin normal të veprimitarës akademike, në respektim të akteve ligjore e nënligjore për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me standarde cilësisë.
3. Shoqëria "KPT" SHPK merr në konsideratë dhe vlerëson të gjitha propozimet që vijnë nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike dhe administrative të KPT. Ajo vendos për çështje të politikave të zhvillimit dhe të zgjerimit institucional të KPT-së.
4. Vendimet e autoritetëve dhe /ose organeve drejtuese akademike të KPT, me pasoja financiare ose që përfaqësojnë devijim nga misioni, parimet dhe filozofia e KPT, nevojitet të marrin në çdo rast edhe miratimin e Asamblesë të Ortakëve të "KPT" SHPK.

Neni 3 - Vendndodhja


KPT ushtron aktivitetin e tij, në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 4, Rr. Xhanfize Keko, Kompleksi Xhura, Zona kadastrale 8130, Nr. Pasurie 5/200, 5/204, Tiranë, Shqipëri.

Neni 4 - Përkufizimet e termave

Në kuptim dhe interpretim të këtij Statuti, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

KPT - Do të thotë Kolegji Profesional i Tiranës, institucion jopublik i arsimit të lartë, me statusin Kolegji Profesional i lartë, i cili ofron programe studimi jouniversitare, me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet "Diplomë Profesionale".

Student - Është individi që ka lidhur kontratën e regjistrit me KPT, dhe është pajisur me numër të veçantë matrikullimi nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.



Viti Akademik - Është periudha kohore e zhvillimit të procesit mësimor, e organizuar në semestra, dhe që përcaktohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin.

Tarifat - Do të thotë tarifa e shkollimit, regjistrimit si dhe pagesa të tjera sipas parashikimeve të Kontratës që lidhet mes Studentit dhe KPT, si dhe akteve rregullatore të KPT.

Regjistrimi - Do të thotë procesi i dorëzimit të dokumentacionit dhe nënshkrimit të kontratës së studentit me KPT, kryerjen e pagesës së tarifave përkatëse, reflektimi në regjistrin e amzës së KPT dhe pajisjen e studentit me numër matrikulimi.

Program studimi me natyrë profesionale - Është programi i studimit që e pajis studentin me njohuri dhe aftësi praktike në një fushë të caktuar të trajnimit profesional, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, i ofruar me 120 kredite ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë Profesionale.

Akte Rregullatore - Janë dokumentacioni që rregullon veprimtarinë e KPT, i cili përfshin pa kufizim rregullore, politika, procedura, planin strategjik të zhvillimit të institucionit, etj që miratohen nga organet përkatëse në përputhje me parashikimet e akteve ligjore, nënligjore në fuqi dhe sipas parashikimeve të këtij Statuti.

Neni 5 - Veprimtaria

KPT është kolegji profesional i lartë, institucion jo publik i arsimit të lartë i cili ofron veprimtari mësimore dhe trajnuese në fusha të ndryshme të arsimit profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike.

KPT realizon veprimtari kërkimore të aplikuara, në përputhje me dhe për aq sa nevojitet për nevojat e realizimit të programeve të studimit me natyrë profesionale, si dhe ofron shërbime.

KPT e kryen këtë veprimtari në përputhje dhe në zbatim të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

KPT kryen edhe aktivitet të pavarur ekonomik që rregullohet nga legjislationi tregtar në fuqi, në kuadër të shoqërisë KPT ShPK.

Neni 6 - Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike

Vizioni

Vizioni i Kolegjit Profesional të Tiranës është të jetë një lider në ofrimin e arsimit profesional duke dhënë kontributin e tij për zhvillimin ekonomik të vendit, duke krijuar profesionistë të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë sonë, duke realizuar veprimtari akademike dhe kërkimore të zbatuara, të integruara, në përputhje me dhe për aq sa nevojitet për nevojat e realizimit sa më cilësor të programeve të studimit me natyrë profesionale.

Misioni i KPT është:

- Të jetë një ndër ofruesit më të rëndësishëm të arsimimit profesional në vend, i cili do të jetë një urë lindhëse midis edukimit akademik dhe trajnimit profesional, duke i ndihmuar studentët në integrimin sa më lehtë në tregun e punës,
- Të aftësojë individët në rritjen e kualifikimit dhe përmirësimit të aftësive profesionale nëpërmjet ofrimit të programeve të studimeve të formimit të vazduhar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës, në përputhje me kërkuesat dhe parashikimet e legjislatacionit në fuqi.
- Të jetë një qendër, ku profesionistët e rinj të vendit të njihen me inovacionet që bëjnë pjesë në programet e studimit të ofruara nga KPT.
- Të sigurojë një bazë të mjaftueshme njohurish për të mundësuar transferimin e studimeve në nivele më të larta universitare.



- e. Të pajisë studentët me aftësi teorike dhe praktike, për t'i bërë ata të aftë të përballen me sfidat në rritje të tregut të punës, nëpërmjet përshtatjes së programeve të studimit dhe planeve mësimore drejt nevojave reale të industrisë.

Për realizimin e Vizionit dhe Misionit të tij, KPT ka si objektiva strategjike:

(i) Objektiva afatgjatë të veprimitarisë arsimore të Kolegjit Profesional të Tiranës:

- a. Të ketë dhe të ofrojë cilësi akademike të standardeve të larta;
- b. Të përgatisë teknikë të lartë dhe profesionistë;
- c. Të ofrojë arsimim profesional dhe veprimtari mësimore sipas standardeve dhe kushteve më cilësore.
- d. Të ofrojë ambiente mësimore teorike me një kuadër të spikatur praktik ku studentët të aftësohen dhe të orientohen për tregun e punës.
- e. Të përvetësojë strategji të mësimit për të lidhur në mënyrë efikase teorinë me praktikën që të vënë në zbatim atë që kanë mësuar në situata konkrete.
- f. Të krijojë një ambient nxitës e mbëshitetës për karrierën dhe zhvillimin për studentët dhe stafin.
- g. Të vendosë në themel të arsimit profesional parime shkencore ku praktika të ndërtuhet me teorinë, parime të cilat janë baza për një sistem modern të arsimit të lartë profesional të orientuar nga tregu dhe kërkosat e tij.
- h. Të sjellë risi në veprimtari kërkimore të aplikuara dhe në kërkim.
- i. Të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë dhe të angazhohet maksimalisht në sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe permiresimin e saj në vijimësi.

(ii) Objektiva të veprimitarisë zhvilluese të Kolegjit Profesional të Tiranës:

- a. Të nxisë pjesëmarrjen e të rinjve në shoqëri; të nxisë ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me inovacionet, mijedisin etj.
- b. Të vlerësojë dhe të promovojë kompetencat sociale të studentëve që përfshijnë punën në grup dhe punën e pavarur.
- c. Të ndërtojë ura të bashkëpunimit me biznesin vendas dhe të huaj, duke mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin eventual të studentëve pas përfundimit të studimeve.
- d. Të pajisë të rinjtë me aftësitë e nevojshme teknike dhe profesionale në një ambient ku arsimi bën dallimin, si dhe t'i hapë një derë drejt progresit të mëtejshëm në arsimimin e tyre universitar dhe jo vetëm.

(iii) Objektiva të veprimitarisë ndërvepruese dhe bashkëpunimit të Kolegjit Profesional të Tiranës:

Kolegji Profesional i Tiranës synon:

- a. Të krijojë dhe të forcojë lidhjen mes arsimit profesional dhe tregut të punës në kushtet e një kuadri ekonomik dinamik.
- b. Të krijojë mundësitet për akses në tregjet e punës dhe të furnizojë këta të fundit me teknikë dhe profesionistë të përgatitur profesionalisht.
- c. Arsimi i lartë profesional ka një natyrë ndërdisiplinore. Për këtë arsy, ai do të shërbejë si një nxitës i sfidave për kërkuesit.
- d. Të promovojë inovacionet, kreativitetin, sipërmarrjen dhe përdorimin e teknologjive të reja, si dhe të sjellë risi në projekt - kërkimet e zbatuara.
- e. Të zhvillojë një përqasje të re për përdorimin dhe mësimin edhe nëpërmjet teknologjive të reja, metodave dhe përqasjeve të reja.
- f. Të zhvillojë instrumente matës të performancës së Kolegjit Profesional të Tiranës dhe përdorimi i tyre dhe i gjetjeve të tyre në funksion të përmirësimit dhe rritjes së vazhdueshme të cilësisë.



Neni 7 - Parimet bazë

1. KPT është një kolegji profesional i lartë, institucion i arsimit të lartë jopublik, laik dhe me karakter jopolitik.
2. KPT gëzon liri akademike në procesin mësimor, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. KPT garanton lirinë akademike që shprehet në respektimin e shumëlojshmërisë së opinioneve, ideve, metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e organizimit të saj.
4. KPT gëzon autonomi akademike, që shprehet ne respektimin e diversitetit të opinioneve, ideve, metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e organizimit të saj, në përputhje me planet dhe me programet mësimore të hartuara e të miratuar nga strukturat përkatëse të KPT, për të gjitha programet e studimit.

Neni 8 - Të drejtat e KPT

Në zbatim të autonomisë institucionale dhe lirisë akademike KPT ka të drejtë:

- a. Të zgjedhë lirisht programet e studimit që do të ofrojë përkundrejt plotësimit të kërkeshave ligjore dhe standardeve akademike;
- b. Të miratojë plane, programe mësimore, tekste në përdorim të studentëve të tij, si dhe literaturën përkatëse në përputhje me standardet ligjore në fuqi;
- c. Të përcaktojë, nëse e shih të arsyeshme, kriterë të veçanta për çdo program studimi, si kusht për pranimin e studentëve në fo, si edhe të përcaktojë procedurat dhe kriteret për dhënen e bursave të studimit.
- d. Të zgjedhë lirisht strukturën institucionale të KPT, autoritetet dhe organet e veta drejtuese sipas këtij Statutit dhe legjispcionit në fuqi;
- e. Të përgjedhë personelin akademik, personelin ndihmës akademik dhe personelin administrativ, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.
- f. Të krijojë lidhje/ura bashkëpunimi me struktura të institucioneve (të njashme ose të përafërt) të arsimit të lartë dhe/ose të trainimit profesional brenda ose jashtë vendit, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë;
- g. Të anëtarësohet në shoqata e organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë publik dhe/ose jopublik;
- h. Të ofrojë shërbime në fushat që kanë lidhje me aspektet e zbatimit praktik të mësimdhënies në përputhje me legjispcionin shqiptar dhe këtë Statut;
- i. Të pranojë donacione nga fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë zhvillimin e Arsimit të Lartë;
- j. Të përdorë tokën, ndërtesa dhe pasuritë e tjera që zotëron ose që ka në posidim për qëllime të arsimit ose që lidhen me të;
- k. Të zotërojë çdo lloj pasurie tjetër sipas legjispcionit në fuqi.

Neni 9 - Paprekshmëria

1. Ambientet e KPT gëzojnë paprekshmërinë që u garanton institucioneve të arsimit të lartë Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
2. Ndëryrja e organeve të rendit publik në ambientet e KPT bëhet vetëm në rastet e parashikuara nga legjispcioni në fuqi, në rastet e nevojës ekstreme dhe me kërkësën dhe/ose lejen e titullarit të KPT.
3. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një falkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhynjnë edhe pa lejen e titullarit.



Neni 10 - Detyrimet e KPT

KPT ka për detyrë:

- Të zhvillojë procesin akademik e të kualifikimit profesional sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në përpulje me normat dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë të vendeve që bëjnë pjesë në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD);
- Të respektojë angazhimet e ndërmarrja prej tij që burojnë nga kontrataat me studentët, personelin e tij, ose me palë të treta;
- Të raportojë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për veprimtarinë e tij mësimore - akademike, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore;
- T'i nënshistrohet vlerësimi dhe akreditimi periodik të programeve të studimit dhe atij institucional;
- Të bëjë publike programet e licencuara të studimit që ofron si edhe statusin e akreditimit të tyre;
- Të bëjë të njohur publikisht raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, si dhe nëse programet e studimit që ofron janë të akredituara në respektim të kushteve dhe afateve ligjore.

Neni 11 - Sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm i cilësisë

- Sigurimi i brendshëm i cilësisë është vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të institucionit.
- KPT harzon politika dhe ngre strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe krijon kushtet për ushtrimin e veprimtarise së jashtme të vlerësimin dhe garantimin e cilësisë.
- Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:
 - Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese) të KPT, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e Akteve Rregulatore, të politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij.
 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, administrative dhe financiare të institucionit dhe harzon raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohet në të gjitha njësítet e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen.
- Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, KPT i nënshistrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit Institucional dhe të programeve të studimit në përpulje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12 - Përfaqësimi

Kolegji Profesional i Tiranës, kolegji profesional i lartë, përfaqësohet sipas rastit nga Administratori dhe/ose Rektori. Përfaqësimi i KPT për çështjet akademike dhe protokollare bëhet nga Rektori i KPT kurse për çështjet administrative dhe financiare përfaqësohet nga Administratori i Kolegit.

Personi juridik "KPT" ShPK është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë, administrimin dhe financimin e institucionit.

KREU II - STRUKTURA E KPT

Neni 13 - Njësítë përbërëse

- KPT përbëhet nga njësítë organizative: bazë, ndihmëse dhe njësi administrative.
- Njësitë bazë dhe ato ndihmëse krijohen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik. Në të ardhmen mund të krijohen edhe njësi të tjera bazë ose ndihmëse, të cilat do të organizohen sipas parimeve të strukturës përkatëse, Akteve Rregulatore të KPT dhe legjislacionit në fuqi.



Neni 14 - Njësia bazë

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të trajnimit, i cili përfshin fusha të përafërtë dhe grupon disiplina mësimore trajnuese të përafërtë.
2. Njësitë bazë në KPT nxisin, programojnë, bashkërendojnë, zhvillojnë, organizojnë dhe administrojnë veprimtarinë e mësimdhënies, të trajnimit dhe të kërkimit të zbatuar në përputhje me dhe për aq sa nevojitet për nevojat e realizimit të programeve të studimit me natyrë profesionale.
3. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën pesë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel mësimdhënës, nga të cilët të paktën dy pedagogë me gradë shikencore ose titull akademik. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës mësimdhënës.
4. KPT përbëhet nga këta departamente/njësi bazë:
 - a. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit.
 - b. Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara;
5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të departamentit si dhe detyra të tjera të tij përcaktohen në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë si dhe në rregulloren bazë të KPT.

Neni 15 - Njësitë ndihmëse mësimore dhe administrative

1. Njësi ndihmëse konsiderohen laboratorët, njësitë didaktike, bibliotekat dhe njësi të tjera që shërbejnë për të realizuar studime, praktikë dhe shërbime në kuadër të zhvillimit të procesit akademik dhe të mësimdhënies.

Njësi ndihmëse mësimore janë:

- a) Laboratorët/ Oficinat;
- b) Biblioteka;
- c) Libraria;

a) Laboratorët /Oficinat

Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion disa mjedise pune (sipas fushave) për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave me mobilim të përshtatshëm, me pajisje matëse moderne dhe laboratorë didaktikë të teknologjisë bashkëkohore. Laboratorët dhe oficinat mbulojnë lëndët sipas fushave.

b) Biblioteka

Biblioteka bën ruajtjen, përdorimin, pasurimin, shpërndarjen dhe huazimin e pasurisë bibliografike të institucionit.

Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës, rregullohen me rregullore e veçantë.

c) Libraria

Libraria tregon pasurinë bibliografike akademike që përdoret në mësimdhënie, si edhe materialet e tjera didaktikë të përgatitura nga personeli akademik.

2. Njësitë administrative të Kolegjit Profesional të Tiranës janë:

- a. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave;
- b. Zyra e Financës;
- c. Sekretaria Mësimore;
- d. Zyra e Protokollit dhe Arkivës;
- e. Zyra e IT dhe Projekteve;
- f. Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve;
- g. Zyra e Kurrikulave.



Veprimtaria e njësive administrative, organizimi, përbërja dhe funksionimi përcaktohet në rregulloren e brendshme të KPT.

Neni 16 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

1. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përherëshme në strukturën organizative të institucionit.
2. Ajo përbëhet nga Kryetari i njësisë, një përfaqësues nga pedagogët e çdo departamenti, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose ai administrativ, një përfaqësues nga organizatazi studentore, si dhe një përfaqësues nga jashtë institucionit, si ekspert për çështje të vlerësimit. Kryetari dhe anëtarët e njësisë emërohen me vendim të Senatit Akademik, me propozim të Rektorit.
3. Njësia vlerëson periodikisht rezultatet dhe efikasitetin e veprimitarive mësimore e veprimitarive formuese e trajnuese, si dhe veprimitarive administrative e financiare të institucionit, si dhe propozon ndryshime përmirësimë të nevojshme.
4. Njësia ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.
5. Ajo bën studime për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni.
6. Në fund të çdo semestri ose para sezont të provimeve, organizon pyetësorin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies përlendët e çdo programi studimi. Rezultatet e vlerësimeve bëhen publike.
7. Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohen në Rregulloren e KPT dhe në vetë rregulloren e NSBC-së.

Neni 17 Auditimi i brendshëm

Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në KPT realizohet nga struktura përgjegjëse për auditimin e brendshëm të KPT, e cila emërohet nga Asambleja e Ortakëve të KPT shpk. Krijimi dhe funksionimi i saj bëhet me rregullore të veçantë.

Kreu III - ORGANIZIMI ADMINISTRATIV I KPT

Neni 18 – Bordi i Administrimit dhe Administratori

1. Bordi i Administrimit

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përbushjen e misionit të KPT, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme e "KPT" Sh.P.K.

Rektori, drejtuesit e njësive bazë dhe administratori nuk mund të janë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të fitohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij.

2. Funksionimi i Bordit Administrativ

Bordi i Administrimit mblidhet të paktën një herë në vit si dhe sa herë që do të jetë e nevojshme për të ushtruar kompetencat e veta ligjore dhe sipas këtij statuti.

Bordi i Administrimit mblidhet me kërkesë të se cilët nga anëtarët e tij si dhe me kërkesë të Administratorit të Institucionit.

Mbledhja e Bordit Administrativ konsiderohet e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën dy të tretat e anëtarëve.

Funksionimi i Bordit rregullohet me rregullore të vecantë.

3. Funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

7

– Mbledhjet e tilla
– Vlefshja e marrëveshjeve, kontrakteve, marrëveshjeve
– Vlefshja e marrëveshjeve, kontrakteve, marrëveshjeve
– Vlefshja e marrëveshjeve, kontrakteve, marrëveshjeve



- a) Garanton qëndrueshmérinë financiare të KPT dhe përbushjen e misionit të tij, duke monitoruar zbatimin e planit finanziar;
- b) Jep mendimin për projekt rregulloren e institucionit të KPT;
- c) Përcakton rregullat dhe destinacionin për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimitarive të tij, me propozim të Administratorit, si dhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit.
- d) Miraton paraprakisht statutin e KPT para se t'i përcillet Senatit Akademik.
- e) Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimitarise së KPT, të përgatitur nga Rektorati.
- f) Vlerëson paraprakisht:
 - i. hapjen, riorganizimin, ose mbylljen e njësive përbërëse të KPT, mbi bazën e propozimeve të njësive bazë.
 - ii. mbylljen dhe riorganizimin e KPT, si dhe ndarjen ose bashkimin e KPT me një IAL tjeter;
 - iii. planin strategjik të zhvillimit të KPT të përgatitur nga Rektorati, pasi ka marrë propozimin e Senatit Akademik. Miratimi i planit strategjik të zhvillimit bëhet më pas nga Asambleja e Ortakëve të KPT Sh.P.K.
- g) Miraton aktet rregullatore mbi kriteret dhe procedurat e punësimit të personelit administrativ.

4. Administratori i KPT

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfukcionimin financiar të KPT. Ai është përfaqësuesi ligjor i KPT për çështjet financiare dhe administrative. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku me nivelin "Master i Shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë si dhe përvojë pune së paku pesë vjet në këto fusha. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i Administrimit sipas propozimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të KPT Sh.P.K.

Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjeter, akademik apo administrativ.

Ai është përfaqësuesi ligjor i KPT për çështje financiare dhe administrative sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe akteve rregullatore të KPT.

5. Funksionet e Administratorit të KPT

Administratori i KPT kryen këto funksione:

- a) Është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjigjës për mirëfunkcionim financiar të KPT.
- b) Është përfaqësuesi ligjor i KPT për çështjet financiare dhe administrative dhe në këtë cilësi ka të drejtë të nënshkruajë kontrata /marrëveshje dhe /ose të angazhojë KPT ndaj palëve të treta.
- c) Harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të KPT dhe në planin buxhetor afatmesëm;
- d) Propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
- e) Ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të KPT në strukturat e varësisë së tij;
- f) I paraqet Bordit të Administrimit, Senatit Akademik dhe Asamblesë së Ortakëve të KPT Sh.P.K. raportin mbi veprimitarinë financiare të KPT në përfundim të vitit akademik;
- g) Ndjek dhe zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
- h) Bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të KPT për çështje të administrimit të përditshëm;
- i) Plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

Neni 19 - Organe Këshilluese

Organ këshillues është Bordi i Punës. Bordi i Punës është një forum i rëndësishëm i cili do të bashkojë përfaqësuesit e KPT me përfaqësuesit e bizneseve kryesore, sipërmarrës dhe administratorë në vend,



ekspertë të fushës së punësimit dhe të tregut të punës, të brendshëm dhe /ose të jashtëm, për tu konsultuar në lidhje me zhvillimet ekonomike – sociale në vend, kurrikulat dhe politikat e angazhimit mes institucionit dhe bizneseve, për t'i bërë ato sa më të dobishme dhe efikase në intereset të të dyja palëve. Gjithashtu, rast pas rasti, për nevoja të zhvillimit dhe funksionimit të KPT, sipas fushë së veprimtarisë dhe ekspertizës, KPT ka të drejtë të marrë konsulencë nga ekspertë/ konsulentë, të brendshëm dhe /ose të jashtëm.

KREU IV - ORGANIZIMI AKADEMIK

Neni 20 - Organet drejtuese akademike në KPT janë:

- Senati Akademik;
- Rektori;
- Asambleja e Personelit Mësimdhënës;
- Këshilli i Etikës;

Neni 21 - Senati Akademik

- Senati Akademik është organi kolegjial më i lartë drejtues akademik i KPT.
- Ai kryesohet dhe thirret nga Rektori i KPT, i cili është Kryetari i tij.
- Senati Akademik mbledhet periodikisht, së paku 2 herë në vit.
- Senati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet kuorumi i nevojshëm prej 2/3 të anëtarëve dhe merr vendim për çështje brenda kompetencave të tij me shumicë të thjeshtë (50%+1) të votave të anëtarëve pjesëmarrës, me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut.
- Senati Akademik përbëhet nga 5 anëtarë.
- Anëtarët e Senatit Akademik janë: Rektori; Përgjegjësit e departamenteve, të emëruar për shkak të detyrës; Anëtarët e zgjedhur janë përfaqësues të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të zgjedhur nga departamentet për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Gjithashtu anëtar i Senatit Akademik është dhe një përfaqësues nga këshilli studentor i institucionit/kryetari, mandati i të cilit është dy vjeçar.
- Mandati i anëtarëve të senatit mbaron:
 - me mbarimin e afatit 4 vjeçar të mandatit,
 - me largimin nga detyra për anëtarët e emëruar për shkak të detyrës,
 - me kërkesën e tyre;
 - me kërkesën e Senatit, kur anëtarët mungon në më shumë se 2 (dy) mbledhje të Senatit,
 - për shkelje të kodit etik të institucionit,
 - në rastet kur anëtarët dënohet me vendim të gjykatës për kryerjen e një vepre penale,
 - në rastin e largimit nga KPT,
 - kur vdes ose humbet zotësinë juridike për të vepruar.
 - Në rast vendimarrje përiorganizim të senatit akademik nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- Funkcionet kryesore të Senatit Akademik në drejtimin akademik-shkencor janë:
 - Garanton autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
 - Mbikqyr respektimin e parimeve të autonomisë dhe të lirisë akademike si dhe të drejtat e studentëve.
 - Miraton planin vjetor të vepririntarive akademike.
 - Jep pëlgimin e tij në lidhje me projekt-buxhetin e institucionit.
 - Miraton me 2/3 e votave statutin e institucionit, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit.
 - Miraton irregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas propozimeve të Rektorit.
 - Miraton programet e reja të studimit, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre.



- h. Miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit të arsimit të lartë mbi bazën e propozimeve të njësive bazë.
- i. Miraton programet e studimit, programet e zhvillimit të praktikave si dhe ndryshimet në këto programe, me propozim të Rektorit dhe/o se njësive bazë.
- j. Propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjeter të arsimit të lartë.
- k. Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës.
- l. Shqyrtion periodikisht raportet për punën mësimore dhe akademike të personelit akademik dhe atë ndihmës akademik të institucionit, mbi përgatitjen e tyre, si dhe cilësinë akademike e profesionale.
- m. Miraton kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe autoriteteve drejtuese të institucionit, në përpulje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 22 - Rektorati

1. Rektorati është një organ kolegjial, i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga:
 - a. Rektori
 - b. Zëvendësrektori (nëse ka të tillë);
 - c. Administratori i KPT
 - d. Përgjegjës i departamenteve
2. Funksionet kryesore të Rektoratit janë:
 - a. Harton planin strategjik të zhvillimit të Institucionit;
 - b. Harton programin vjetor të veprimitarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik.
 - c. Paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të praktikave profesionale dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre.
 - d. I propozon Senatit hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësive të tjera bazë ose ndihmëse.
 - e. Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik të cilat i drejtohen atij.
 - f. Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimitarive të institucionit.
 - g. Propozon strukturën e përgjithshme institucionale si dhe kategoritë e personelit akademik që nevojiten sipas niveleve të studimit.
 - h. Shqyrtion trajtimin e rasteve përashtimore, bazuar në kërkesën me shkrim të personit të interesuar. Në qdo rast, vendimi nuk mund të anashkalojë detyrimin për shlyerjen e detyrimeve që garantonë përmbrushjen e standardeve akademike.
 - i. Harton reportin vjetor të veprimitarive mësimore e kurrikulare dhe e paraqesin atë për miratim në Senat.
 - j. Lëshon urdhëra dhe udhëzime për të gjitha strukturat përbërëse të KPT.
3. Rektorati si organ kolegjial funksionon me mbledhje. Mbledhja e Rektoratit kryesohej dhe thirret nga Rektori.
4. Organizimi dhe veprimitaria e Rektoratit përcaktohet me Rregullore të veçantë.

Neni 23 - Asambleja e Personelit Mësimdhënës

Asambleja e Personelit Mësimdhënës përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë. Asambleja e Personelit Mësimdhënës në KPT zgjedh anëtarët e Senatit Akademik të KPT.

Neni 24 - Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjial vendimmarrës i cili ngrihet pranë KPT si një strukturë e përhershme, e cila shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimitarë e procesit mësimor, akademik



- si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
2. Këshilli studion sjellje të ndryshme të personelit akademik dhe atij ndihmës të institucionit nëse përbënë shkelje të etikës ose jo. Këshilli shqyrton gjithashtu edhe sjellje të studentëve gjatë veprimtarisë së tyre mësimore e akademike në institucion nëse ato përbënë shkelje të etikës së studentit.
 3. Këshilli i Etikës mblidhet sa herë ka çështje për të diskutuar. Ai merr vendim me shumicë të thjeshtë (50%+1) dhe i bën propozime Rektorit për këto çështje.
 4. Këshilli përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët përzgjidhen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit, përmes një procedure përzgjedhëse të bërë publike paraprakisht. Njëri prej anëtarëve të Këshillit të Etikës i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.
 5. Në lidhje më çështjet e etikës dhe të integrititetit akademik, çfarë nuk parashikohet në këtë Statut dhe në Rregulloren e KPT, do të rregullohet nga Kodi i Etikës, pas miratimit në Senat.

Neni 25 - Autoritete Drejtuese Akademike

- a. Rektori;
- b. Zëvendësrektori;
- c. Përgjegjësi i Departamentit;

Neni 26 - Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i KPT. Ai është dhe përfaqësuesi ligor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori mban titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar".
3. Rektori emërohet dhe shkarkohet nga Administratori me propozim të Asamblesë së Ortakëve të KPT shpk. Rektori ka mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Marrëdhëniet e tij me institucionin përcaktohen në kontratën e punës.
4. Mandati i Rektorit mbaron kur:
 - a. ai largohet,
 - b. jep dorëheqjen për çështje personale dhe/ose shëndetësore,
 - c. kur prishet kontrata e punës,
 - d. kur i përfundon kontrata e punës, dhe
 - e. në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmton integritetin e institucionit.
5. Rektori ka këto kompetenca kryesore:
 - a. Kryeson Senatin Akademik dhe raporton para tij;
 - b. Nënshkruan kontratat e punës së personelit akademik dhe ndihmës akademik në KPT;
 - c. I paraqet Senatin Akademik planin strategjik të zhvillimit të Institucionit;
 - d. Drejton dhe koordinon aktivitetin akademik dhe mësimor të KPT;
 - e. Ndjek dhe siguron zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, vendimet e Rektoratit në lidhje me aktivitetin mësimor, akademik dhe të kualifikimit profesional, si dhe nxjerr akte të nevojshme në zbatim të tyre;
 - f. Monitoron dhe garanton lirinë akademike të personelit akademik;
 - g. Nënshkruan diplomat e KPT si dhe certifikatat e tjera në KPT, nëse do të ofrohen në të ardhmen, pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin;
 - h. Merr pjesë në hartimin dhe miratimin e rregulloreve dhe të akteve rregullatore;
 - i. Kryeson procesin e shqyrtimit të kandidaturave të personelit akademik, merr në konsideratë mendimet e drejtuesve të njësive bazë si dhe emeron personelin akademik dhe ndihmës akademik të brendshëm dhe të jashtëm në KPT;
 - j. Përfaqëson institucionin për çështje me karakter akademik, në përputhje me kompetencat e tij të përcaktuara në këtë statut.
 - k. Përfaqëson institucionin në Konferencën e Rektorëve;



- I. Mbikqyr jetën dhe aktivitetet studentore si grupet studentore si dhe Zyrën e Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve.
- m. Kryen çdo detyrë tjetër me karakter akademik që mund t'i delegohet nga Senati Akademik, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 27 - Drejtuesi i njësisë bazë

1. Përgjegjësi i Departamentitës eshtë autoriteti drejtues akademik i Departamentit.
2. Rektori i KPT emëron Përgjegjësin e Departamentit me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Marrëdhëniet e tij me KPT përcaktohen në kontratën e punës.
3. Përgjegjësi i Departamentitës eshtë person akademik dhe i përkthet kategorisë "Profesor", ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"). Procedura e përzgjedhjes përcaktohet në rregulloren e KPT.
4. Mandati i Përgjegjësit të Departamentitës mbaron kur ai largohet për çështje personale dhe/ose shëndetësore, kur prishet kontrata e punës, kur i përfundon kontrata e punës dhe në rastet kur me veprimet ose mosveprimet e tij dëmon integritetin e institucionit.
5. Përgjegjësi i Departamentit ka këto kompetenca:
 - a. Organizon, koordinon dhe drejton aktivitetin mësimor dhe akademik të Departamentit.
 - b. Shqyrtzon dhe miraton planet mësimore dhe programet e studimit dhe propozon hapjen e programeve të reja të studimit, si dhe ndryshimet e nevojshme në programet e studimit.
 - c. Përgatit rregulloren mësimore për çdo program studimi të njësisë së tij, dhe ia dërgon për miratim Senatit Akademik.
 - d. Shqyrtzon dhe miraton tekstet mësimore që do të përdoren për mësimdhënie në KPT për departamentin që ai drejton.
 - e. Ndjeq realizimin e programit mësimor sipas planit të miratuar dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënieve.
 - f. Miraton e firmos tezat e provimeve.
 - g. Merr pjesë në komisionet e përzgjedhjes së pedagogëve të rinj për departamentin që drejton.
 - h. Bën vlerësimin e pedagogëve të departamentit gjatë vitit akademik.
 - i. Drejton komisionet e transferimit dhe të mobilitetit të studentëve, të ndërprerjes dhe rifillimit të studimeve sipas parashikimeve të Rregullores së KPT.
 - j. Së bashku me sekretaren përkatëse nënshkruan listën emërore të studentëve që fitojnë të drejtën e dhënies së provimit, të plotësuar nga Sekretaria mësimore që i vihet në dispozicion Pedagogut para hyrjes në provim.
 - k. Propozon masat disiplinore për studentët në Këshillin e Etikës.
 - l. Propozon masa disiplinore në Këshillin e Etikës për anëtarë të personelit akademik dhe atij ndihmës që kanë kryer veprime në kundërshtim me statutin dhe rregulloren e KPT, kanë shkelur Kodin e Etikës, apo nuk kanë respektuar detyrimet e përcaktuara në Kodin e Punës ose në kontratën e punës.
 - m. Ka të drejtë të propozojë kuotat dhe kriteret e praminit për çdo program studimi të njësisë bazë përkatëse, të cilat në çdo rast miratohen nga Senati Akademik i Kolegjit Profesional të Tiranës.

Neni 28 - Autoritete të tjera

Autoritete të tjera të KPT janë:

- a. Sekretari i Përgjithshëm Akademik;
- b. Zëvendësrektori.

Neni 29 - Sekretari i Përgjithshëm Akademik

Sekretaria Mësimore drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm Akademik dhe përbëhet nga koordinatoret e Departamenteve.



Sekretari i Përgjithshëm Akademik ka këto kompetenca:

- Drejtton dhe koordinon punën e Sekretarisë Mësimore dhe të koordinatoreve për zhvillimin e veprimtarisë mësimore;
- Përgatit kalendarin akademik të mësimdhënies në KPT dhe garanton zbatimin e tij në bashkëpunim me departamentet përkatëse.
- Përgjigjet për cilësinë dhe saktësinë e dokumentacionit, për të dhënat nga zhvillimi i procesit mësimor, studentët, të dhënat statistikore që mbidhen, përpunohen, raportohen pranë MASR ose përdoren për lëshimin e diplomave, certifikatave, kur ka të tilla, dhe dokumenteve të tjera të lidhura me mësimdhënien në KPT.
- Ndjeq përbushjen e detyrimeve kontraktuale të personelit akademik ne KPT për sa i përket ngarkesës së tyre mësimore dhe informon Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave.
- Koordinon procesin e transferimit, të modalitetit, të ndërprerjes dhe të rifillimit të studimeve në KPT sipas parashikimeve të Rregullores së KPT.
- Përgatit paraprakisht listën emërore të studentëve që fitojnë të drejtën e hyrjes në provim dhe pas miratimit nga Përgjegjësi i Departamentit, i vihet në dispozicion pedagogut para hyrjes në provim.
- Zbaton çdo detyre tjetër që mund ti ngarkohet nga Rektori dhe raporton tek ai për realizimin e saj.

Neni 30 - Zëvendësrektori

Zëvendësrektori plotësohet si funksion në varësi të nevojave të institucionit. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Rektori, me propozim të Asamblesë së Ortakëve, dhe pas miratimit në Senatin Akademik për një mandat 5 vjeçar, me të drejtë riemërimi.

Zëvendësrektori është personel akademik i kategorisë "Profesor" ose së paku duhet të ketë titullin "Profesor i asociar".

Zëvendësrektori përfaqëson Rektorin në fushën e veprimtarisë akademike në rast të mungesës së tij, dhe kryen detyrat e ngarkuara prej tij dhe raporton pranë tij. Fusha e veprimtarisë së tij përcaktohen në aktin e emërimit.

KREU V - STUDIMET PROFESSIONALE

Neni 31 - Format e studimit

- Forma e studimeve në KPT është si rregull me kohë të plotë, të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas standardeve të hapësirës europiane të studimeve.
- Programet e studimit në KPT si rregull ofrohen në gjuhën shqipe, por mund te ofrohen dhe në një nga gjuhët e Bashkimit European të miratuar me aktin përkatës të hapjes së programit të studimit.
- KPT ofron programe të licensuara të studimeve jouniversitare, të larta, me karakter profesional, me jo më pak se 120 kredite. Ai mund të ofrojë në të ardhmen edhe programe studimi me karakter profesional me 60 kredite ose studime universitare të ciklit të parë, në përputhje me licensën/autorizimin përkatës të dhënë nga organi kompetent sipas parashikimeve të legjislatcionit në fuqi.
- Në rastet kur për module ose lëndë të veçanta numri i studentëve është i vogël (nuk arrihet të krijohet një grup mësimor), lënda/moduli zhvillohet me program individual/të veçantë me titullarin e lëndës/ apo edhe lektorin nën kujdesin e titullarit të lëndës. Rregullat specifike të organizimit të kësaj forme të studimit përcaktohen në rregulloren mësimore të programit të studimit.

Neni 32 - Programet e studimit

- Programi i studimit mund të propozohet, hartohet dhe rishikohet me kërkesë të Departamentit, dhe/ose Zyrës së Kurrikulave, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës e dinamikave të brendshme të tij.
- Propozimi për hapjen, rishikimin apo mbylljen e një programi studimi, në çdo rast vjen i argumentuar. Ai shqyrtohet në Departament dhe nga Zyra e Kurrikulave. Në këtë shqyrtim mund të merren në konsideratë rezultatet dhe gjetjet vjetore të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në lidhje me hapjen, rishikimin



apo mbylljen e një programi studimi. Propozimi dërgohet për miratim në Rektorat e më pas në Senatin Akademik. Miratimi përfundimtar bëhet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik.
- Plani mësimor për çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të herëpashershme me Bordin e Administrimit, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës.
- Çdo program studimi irregullohet me rregullore mësimore të veçantë.
- KPT shpal publikisht, kuotat dhe kriteret e pranimit, programet e hapura dhe ato të akredituara, përpara fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve.

Neni 33 - Kohëzgjatja e studimeve

- Kohëzgjatja normale e studimeve është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- Afati normal i studimeve për programet jouniversitare, me natyrë profesionale është 2 (dy) vite akademike.

Neni 34 - Transferimet dhe ekuivalentimi i krediteve

- KPT ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtë cikël studimi, brenda tij apo institucionë të ndryshme të arsimit të lartë.
- Në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, KPT pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose private, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në institucionë të tjera, nga programe studimi jouniversitare të natyrës profesionale, ose programe studimi të ciklit të parë, Bachelor.
- Transferimet në KPT lejohen brenda të njëjtë cikël studimi në fusha të njëjtë studimi ose të përaferta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.
- Modalitetet e kësaj procedure përcaktohen në një rregullore të veçantë në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- KPT në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, kryhen edhe njohje të krediteve duke mundësuar mobilitetin e studentëve nga një program studimi në tjetrin, brenda KPT, por pa cënuar rregullat e përcaktuara për pranimin në programin e studimit. E njëjta procedurë ekuivalentimi ndiqet edhe në rastin kur studenti regjistrohet për të ndjekur një program të dytë studimi, brenda të njëjtë cikël studimi.

Neni 35 - Ndjekja e një programi të dytë studimi të të njëjtë cikël

Individët, që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtë cikël. Këta individë duhet të përmbushin kriteret e pranimit njësoj si ata që regjistrohen për herë të parë në këtë program studimi. Procedura për ndjekjen e programit të dytë të të njëjtë cikël përcaktohet me rregullore të veçantë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 36 - Diplomimi

- Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPT, fiton të drejtën e marjes së diplomës.
- Elementet përbërës, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin hartohen në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë Përgjegjëse për Arsim. Forma e diplomës, elementet e sigurisë, si dhe elemente të tjera të saj përcaktohen me dokument të veçantë.
- Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike, nënshkruhet nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe Rektori dhe vuloset me vulën e KPT.
- Diploma nuk mund të lëshohet dublikatë. Ajo jepet vetëm një herë.
- Diploma rregjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
- Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni.



KREU VI - PERSONELI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Neni 37 - Personeli i Kolegjit

- Personeli i KPT përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ.
- Personeli i KPT mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar si dhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.
- Personeli punësohet sipas formave të parashikuara në këtë statut dhe në aktë të tjera ligjore e nënligjore të aplikueshme. Kontrata e punës lidhet mbështetur në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Kodin e Punës. Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj, përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe KPT, në përputhje me këtë Statut.

Neni 38 - Personeli akademik dhe kategoritë

- Personeli akademik gjëzon status të veçantë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të KPT. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
- Personeli akademik kryen veprimitari të mësimdhënieve, shërbime mbështetje dhe për zhvillimin e institucionit, këshillim për studentët, tutoriat, detyra administrative si dhe veprimitari të tjera.
- Personeli akademik në KPT sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen kategorizohet në:
 - Profesorë;
 - Lektorë;
 - Asistentë - Lektorë.

Nën kategorizime të tjera brenda kategorive të sipërcituara, rregullohen më aktet rregulatorë të KPT.

- Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të ketë së paku diplomë Master Profesional.

Neni 39 - Personeli akademik, punësimi dhe vlerësimi

- Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e saj dhe miratohen nga Rektori.
- Personeli akademik përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një Komision Rekrutimi, i cili ngrihet me urdhër të Rektorit. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të përbushjes së kritereve të shpallura akademike dhe ekspertizës profesionale.
- Kriteret, rregulat dhe proceduaret për punësimin e personelit akademik përcaktohen në aktet nënligjore në fuqi dhe aktet rregulatorë të KPT.
Personeli akademik, duhet të zbatojë Kodin e Etikës, këtë statut si dhe aktet e tjera rregulatorë të KPT.
- Anëtarët e personelit akademik i nënshtronen në mënyrë periodike, vlerësimëve dhe trajnimeve.

Neni 40 - Personeli ndihmës-akademik

- Personeli ndihmës-akademik ndahet në personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ndihmës-akademik me karakter administrativ.
- Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimitarive të mësimdhënieve, laboratore, shërbime për zhvillimin e KPT, këshillim për studentët, detyra administrative.
- Personeli ndihmës-mësimor është pjesë e njësisë bazë dhe shërben përmes mbështetjen e veprimitarive të kësaj të fundit dhe ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.
- Personeli ndihmës-mësimor përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një Komision Rekrutimi ku marrin pjesë Rektori dhe drejtuesit e njësive bazë.



- e. Të nënshkruajë kontratën e studentit, në momentin e regjistrimit në KPT;
- f. Të sigurohen nga KPT në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktiveve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe Ministrit të Financave.
- g. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në Këshillin e Studentëve dhe organet e institucionit, në përputhje me legjisacionin dhe statutin e KPT;
- h. Të transferojë kreditet/studimet nga IAL të tjera në KPT dhe anasjelltas.
- i. Të jetë i barabartë, por i ndryshëm.
- j. Të organizohet lirish në grupime me karakter social, ekonomik, kulturor, sportiv dhe akademik.

4. Studenti ka për detyrë:

- a. Të zbatojë rregullat e përcaktuara nga KPT;
- b. Të paguajë tarifën e shkollimit si dhe tarifa për shërbime të tjera sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e studentit dhe aktete rregullatore të KPT;
- c. Të respektojë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- d. Të respektojë Kodin e Etikës, Statutin, Rregulloret dhe aktet e tjera të KPT;
- e. Të ndjekë rregullisht ushtrimet, leksionet dhe laboratorët sipas programit të studimit;
- f. Të marrë pjesë në veprimtari të tjera akademike.

5. Karta e Studentit

Studentët pajisen me Kartën e Studentit, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit.

Neni 45 - Pranimi i studentëve

1. Në programet e studimit pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kriterë:
 - a. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e Maturës Shtetërore, si edhe zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose diplomës përkatëse, që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjisacionit në fuqi;
 - b. Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktiveve të kontratës së Studentit;
 - c. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës;
 - d. Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të KPT.
2. Numri i studentëve të pranuar bazohet në mundësitetë reale të çdo Departamenti për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkura nga Ministria përgjegjëse per arsimin në përputhje në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në aktet nënligjore përkatëse.

Neni 46 - Këshilli i Studentëve dhe pjesëmarrja në qeverisjen e institucionit

1. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, në nivel institucioni të arsimit të lartë si dhe në nivel kombëtar.
2. KPT inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarjen e organeve drejtuese të tij, organizimin e lirë, dhe shprehjen e organizuar të mendimit të tyre.
3. Këshillat e Studentëve janë organizime të pavarura të studentëve të KPT, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këshilli realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të KPT, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve.
4. Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, në përputhje me një rregulllore të veçantë të propozuar nga vetë studentët dhe të miratuar nga Senati Akademik, e cila i bashkëlidhet rregullores së institucionit dhe mbështetet në legjisacionin në fuqi.



5. Këshilli i studentëve nuk mund të organizohet me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucionit.
6. Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe propozime për probleme me interes të përgjithshëm të Kolegit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
7. KPT e mbështet Këshillin e Studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre.

Neni 47 - Bursat për studime

1. KPT mund të ofrojë disa lloje bursash studimi si mbështetje ekonomike për kategori të caktuara sociale, si dhe bursa me kriter rezultatet e Maturës Shtetërore / akademike për studentët e shkëlqyer etj. Bursa e studimit mund të jetë e plotë ose e pjesshme.
2. Kriteret, procedura e aplikimit, e akordimit të bursave dhe kushtet e zbatimit te tyre përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 48 - Dokumentacioni i procesit mësimor dhe i të dhënave të studentëve

KPT mban në formë të shkruar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi:

1. Regjistrin themeltar të studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në KPT;
2. Regjistrin e arritjeve akademike, që është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në KPT.
3. Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, që është dokumenti që vërteton emërtimin e tyre nga KPT.

Regjistrat shpërndahen nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë priudhën kohore të ekzistencës së KPT. Regjistrat plotësohen edhe në formë elektronike.

KPT mbledh, ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë pa kufizim, Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Të dhënat personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit te KPT.

KREU IX - FINANCIMI

Neni 49 - Burimet e financimit

1. KPT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Ai përcakton për çdo fillim viti akademik projektbuxhetin përkatës të institucionit të ndarë në Departamente, të cilin e miraton sipas përcaktimeve të bëra në këtë statut. Burimet financiare ndahen në parësore dhe dytësore.
2. Burimet parësore: Financimi nga Shoqëria tregtare "K.P.T." sh.p.k., ku përfshihen edhe të ardhurat nga tarifat e studimit dhe shërbime të tjera.
3. Burimet dytësore.
 - a. Të ardhura nga shërbime që KPT ofron për të tretët.
 - b. Donacione nga sektori publik.
 - c. Donacione nga sektori privat.
 - d. Donacione nga shoqëria civile.
 - e. Donacione nga subjekte ndërkombëtare.
 - f. Projekte të aplikuara dhe të fituara nga KPT.
 - g. Çdo burim tjetër i ligjshëm.
4. Të gjitha të ardhurat nga burimet dytësore përdoren vetëm në shërbim të institucionit.



KREU X - DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 50 - Vula zyrtare dhe stema

KPT ka vuën zyrtare, të njomë dhe të thatë, ku shkruhet "KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS" me logon e KPT.

Neni 51 - Të ndryshme

- Statuti i KPT miratohet dhe ndryshohet me vendim të Senatit Akademik me dy të tretat e votave dhe i dërgohet për aprovim në Ministrin përgjegjës për arsimin.
- Kur Ministri përgjegjës për arsimin nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, statutu konsiderohet i miratuar.
- Të drejtën e interpretimit të këtij Statuti e ka Senati Akademik i Kolegit Profesional të Tiranës.
Në zbatim të këtij Statuti, dhe të legjislacionit në fuqi, hartohet rregullorja e institucionit, rregulloret e programit të studimit, aktet e tjera të cituara në këtë statut, si dhe akte të tjera në zbatim të legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, nga organet dhe strukturat përkatëse të KPT, sipas kompetenca dhe tagrave të tyre.

Neni 52 - Dispozita kalimtare

Ky statut hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri përgjegjës për arsimin.

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, shfuqizohet statuti ekzistues i Kolegit Profesional të Tiranës, i miratuar me vendimin e Senatit Akademik datë 24. 12. 2015.

Aktet e tjera rregulla të KPT, mbeten në fuqi deri në shfuqizimin e tyre përkatësisht nga Senati Akademik dhe miratimin e akteve të tjera rregulatorë.


Procesi i riorganizimit fillon pas miratimit te këtij statuti nga Ministri përgjegjës për arsimin.

Çdo gjë tjetër që nuk gjen rregullim në këtë statut, do të rregullohet me rregullore të veçantë.

Miratoi:

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Luan KARÇANAJ



Shtojca A - Struktura Akademike

KPT përbëhet nga dy Departamente:

- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
- Departamenti i Elektromekanikës dhe Sistemeve të Apikuara

Shtojca B - Struktura kryesore administrative

Strukturat kryesore administrative të KPT janë:

- Bordi i Administrimit
- Administratori

Shtojca C -- Organigrama e kolegjit profesional të lartë "Kolegji Profesional i Tiranës"

(bashkëlidhur)



ORGANIGRAMA E KOLEGJIT PROFESSIONAL TE TIRANËS

